



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME E NDËRTIMIT "KARL GEGA" TIRANË**

Nr. 451 Prot.

Tiranë, më 21 / 09 / 2026

Lënda : Njoftim për për vend të lirë pune

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore

DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit Nr.15 datë 16.02.2017 , "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", VKM nr 554 date 31.07.2019 " Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjensisë Kombëtare të Punesimit dhe Aftësive (AKPA) , Udhëzimit të MFE, Nr.25, datë 01.09.2023 nr 15702 prot "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet arsimit profesional" Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Nr.759, datë 30.09.2024 "PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË, MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJEN E NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONEVE, OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT" Udhëzimi i Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 4, datë 18.8.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 759, datë 30.9.2024 ofruesi publik i AFP-së ,neni 118 pika 3. Shkolla e mesme e ndërtimit "Karl Gega", ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

1- Instruktor I praktikës profesionale në drejtimin Mekanik – 1 (Një) Instruktor I Praktikës Profesionale

Aplikanti për Instruktor të praktikës profesionale në ofruesit e AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteria të posaçme për personelin Instruktor I praktikës profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim të mesëm profesional:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
- d) aftësi të tjera nëse kërkohen.

3. Dokumentet e aplikimit Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda afateve të aplikimit të përcaktuara në shpallje 01 / 10 / 2026

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

DREJTOR
Ing. Indrit Gorçe

